



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

NR. 05 DT 16.06.2023

PËR MIRATIM LINJASH RRETHQYTETËSE TË TRANSPORTIT TË
UDHËTARËVE

Mbështetur në ligjin Nr. 8308, dt 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar), neni 15, pika 1, gërma “ç” dhe paragrafi i dytë i nenit 19, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut

VENDOSI:

1. Të miratojë në parim linjat rrethqytetëse si dhe shtimet e orareve në linjën ekzistuese Podgorie –Korçë-Kthim sipas vendimit nr.21 dt.23.12.2019, të kërkuara nga Bashkia Maliq

Nr	Bashkia kërkuese	Linja rrethqytetëse	Nr.i orareve të shërbimeve në linjë
1	Bashkia Maliq	Velitërnë-Korçë-Kthim	Nisja: 07:30, 10:00, 12:30 Kthimi: 08:45, 11:30, 14:00
	Linja te reja	Shqitas- Korçë-Kthim	Nisja: 07:30, 10:30, 12:30 Kthimi: 10:00, 12:00, 14:00
		Leminot- Korçë-Kthim	Nisja: 07:30, 10:30, 12:30 Kthimi: 10:00, 12:00, 14:00
	Shtim oraresh	Podgorie- Korçë-Kthim	Nisja: 07:30, 08:00, 08:30, 09:00, 09:30, 10:00, 10:30, 11:00, 11:30, 12:00, 12:30, 13:00, 13:30 Kthimi: 09:30, 10:00, 10:30, 11:00, 11:30, 12:00, 12:30, 13:00, 13:30, 14:00, 14:30, 15:00, 15:00

2-Oraret janë sipas kërkesës së Bashkisë Maliq, pikat e nisjes dhe të mbëritjes do të jenë ato ekzistuese.

3- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Bashkia Maliq, subjektet e transportit të udhëtarëve .

4.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konc: Oljona Beqiraj
Juristi: Gjergji Kristo
Sekretari i Këshillit të Qarkut:
Bashkim Muço



Ana VERUSHI

Kryetar i Këshillit të Qarkut





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

Për miratimin e linjave Velitërnë-Korçë-Kthim, Shqitas- Korçë-Kthim, Leminot- Korçë-Kthim, si dhe shtimin e orareve për linjën ekzistuese Podgorie- Korçë-Kthim

Në datën 12.04.2023, pranë Këshillit të Qarkut Korçë, është paraqitur kërkesa e Bashkisë Maliq për miratimin e 3 linjave të reja Velitërnë-Korçë-Kthim, Shqitas- Korçë-Kthim, Leminot- Korçë-Kthim si dhe shtimin e orareve për Linjën ekzistuese Podgorie-Korçë-Kthim pasi oraret aktuale nuk ju përgjigjen plotësisht banorëve.

Këshilli i Qarkut Korçë me vendimin Nr. C3, datë 17.03.2021 "Për miratimin e linjave rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve, ka miratuar linjat rrethqytetëse mbi bazën e të cilave ushtrojnë aktivitet subjektet që operojnë në fushën e transportit në Bashkinë Maliq.

Duke marrë parasysh kërkesat e shumta të banorëve të fshatrave Velitërnë, Leminot dhe Shqitas për lëvizjen e tyre drejt qytetit të Korçës, është kërkuar nga Bashkia Maliq miratimi i këtyre 3 linjave të reja si dhe shtimi i orareve në linjën ekzistuese Podgorije-Korçë-Kthim për t'ju shërbyer plotësisht banorëve.

Dokumentacioni i paraqitur është konform Ligjit Nr.8038, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", në këto kushte i propozojmë Këshillit të Qarkut miratimin e kërkesës.

KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT

ANA VERUSHI

